



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

PLANI I PUNËS

PËR VITIN 2026

Përmbajtja Përmbajtja	2
Hyrje	3
Vizioni dhe Misioni i DKA-së	4
Objektivat strategjike	4
Objektivi Strategjik 1: Zhvillimi profesional i mësimdhënësve.....	4
Objektivi Strategjik 2: Zbatimi i kurrikulës së re.....	5
Objektivi Strategjik 3: TIK-u dhe mjetet e konkretizimit	5
Objektivi Strategjik 4: Sigurimi i cilësisë.....	5
Objektivi Strategjik 5: Infrastruktura fizike.....	6
Objektivi Strategjik 6: Arsimi dhe aftësimi profesional.....	6
Orientimi i përgjithshëm	6
Rezultatet e pritshme.....	7
Monitorimi dhe vlerësimi i përgjithshëm	8
Të dhënat e përgjithshme.....	9
Pasqyra e nr të mësimdhënësve dhe nxënësve sipas institucioneve edu.-arsimore publike..	10
Stafi administrative dhe punëtorët teknik.....	11
Pedagogët, Psikologët dhe Bibliotekistët nëpër shkolla	12
Numri i nxënësve me nevoja të veçanta në vitin shkollor 2023/24.....	13
Aktivitetet e DKA-së në Podujevë për vitin 2026.....	14
Aktivitetet që kanë të bëjnë me procesin edukativo - arsimor.....	15
Aktivitetet për përgatitjen e objekteve shkollore.....	16
Bashkëpunimi i DKA-së me organet e sigurisë, OJQ-të, mediat dhe komunitetin	16
Aktiviteti dhe bashkëpunimi i DKA-së me Kryetarin e Komunës, MASHT-in,	17
Bashkëpunimi me përfaqësuesin e komunës për IE	18

Hyrje

Në këtë plan janë të përfshira të gjitha aktivitetet e planifikuara të Drejtorisë së Arsimit, për katër nivelet shkollore sipas SNKA¹ -së, dhe atë si vijon:

- SNKA 3 - Arsimi i Mesëm i Lartë (Klasat X-XII),
- SNKA 2 - Arsimi i mesëm i ulët (Klasat VI-IX),
- SNKA 1 - Arsimi fillor (Klasat I-V),
- SNKA 0 - Klasat Parafillor/Përgatitore (5-6 vjeç) dhe Arsimi Parashkollor (lindje-5 vjeç).

Ky plan i ka për bazë aktivitetet që do të realizohen në të gjitha Shkollat Filllore të Mesme të ulëta dhe të Mesme të Larta (Gjimnaze dhe Shkolla Profesionale) në komunën e Podujevës.

Pra, plani përfshinë aktivitetet për përgatitjen e vitit të ri shkollor, aktivitetet për përgatitjen e objekteve shkollore, bashkëpunimin e DKA-së me kryetarin e komunës, MASH-in, drejtoritë e tjera komunale, me qytetarët, komunitetin prindëror si dhe bashkëpunimi i DKA-së me organet e sigurisë, OJQ-të, mediat, komunitetin, etj.

Plani ka për bazë edhe elementet të cilat kanë të bëjnë me përcjelljen e trendëve të reja zhvillimore në arsim, pasurimin, furnizimin dhe shfrytëzimin permanent të teknologjisë arsimore nëpër shkolla.

¹ SNKA-Sisitemi Ndërkombëtar i Klasifikimit të Arsimit

Vizioni dhe Misioni i DKA-së

Në KAB për komunën e Podujevës janë përcaktuar vizioni, misioni dhe objektivat strategjike të zhvillimit të arsimit në nivel komune që është bazament për çdo plan vjetor.

Vizioni: Sistem bashkëkohor i shkollimit që ofron gjithëpërfshirje, mësimdhënie cilësore dhe mundësi të zhvillimit të potencialit për secilin nxënës në funksion të të nxënës gjatë gjithë jetës, punësimit të të rinjve, demokratizimit të shoqërisë dhe zhvillimit ekonomik në nivel komune.

Gjithëpërfshirja, mësimdhënia cilësore, mundësitë e zhvillimit të potencialeve për secilin nxënës, punësimi i të rinjve, demokratizimi dhe zhvillimi ekonomik në nivel komune, janë fjalët kyçe të vizionit për arsim në komunën e Podujevës, të cilat përbëjnë bazën e orientimit për misionin e komunës së Podujevës, i cili reflektohet në deklaratën në vijim:

Misioni: Ofrimi i arsimit cilësor për të gjithë nxënësit e Komunës së Podujevës përmes mësimdhënies cilësore bashkëkohore që mbështetet me zhvillim të vazhdueshëm profesional të mësimdhënësve, përdorimit të teknologjisë moderne arsimore dhe mjeteve mësimore, krijimit të kushteve optimale dhe ambientit miqësor dhe të sigurt në shkolla, ndërlikohet së arsimit dhe aftësimi profesional me tregun e punës, si dhe përmes fuqizimit të autonomisë së shkollës dhe mekanizmave të përgjegjësisë dhe llogaridhënies.

Objektivat strategjike

Objektivi Strategjik 1: Zhvillimi profesional i mësimdhënësve - Një nga prioritetet e komunës së Podujevës është përfshirja e të gjithë mësimdhënësve në trajnime cilësore që ndihmojnë mësimdhënësit që të jenë më kreativë në mësimdhënie dhe në ofrimin e përkrahjes së nevojshme për nxënës në zotërimin e kompetencave kryesore. Fokusi do të jetë në përcaktimin e qartë të rolit të DKA në zhvillimin e mekanizmave për identifikim të nevojave të mësimdhënësve për zhvillim të vazhdueshëm profesional, financim, monitorimin si dhe në përkrahjen e shkollave për ZHPM me bazë në shkollë.

Objektivi Strategjik 2: Zbatimi i kurrikulës së re - Me kurrikulën e re, roli i shkollës është sigurimi i një mjedisi mundësues për zhvillim të kompetencave. Përmbushja e këtij roli të veçantë, përveç trajnimit të mësimeve, lidhet edhe me ngritjen e kapaciteteve në udhëheqje të procesit të zbatimit të kurrikulës në nivel shkolle, organizimin e punës së departamenteve/aktivave profesionale në shkolla, sigurimin e mjeteve e materialeve mësimore, si dhe përkrahjen nga DKA.

Objektivi Strategjik 3: TIK-u dhe mjetet e konkretizimit - Përdorimi i TIK-ut ndërlidhet me pajisjen e shkollave me kompjuterë, qasja në internet, shfrytëzimin e burimeve online, sigurimin e mbështetjes teknike dhe mirëmbajtja e pajisjeve dhe përgatitjen e mësimeve për shfrytëzimin e TIK. Këto aspekte adresohen në masat e vendosura për arritjen e këtij objekti strategjik. Objektivi ndërlidhet me objektivin për zbatim të kurrikulës së re, strategjin e Arsimit 2022-2026 dhe me prioritetet e komunës së Podujevës për të siguruar përdorim të TIK-ut në procesin e mësimdhënies dhe të nxënës.

Objektivi Strategjik 4: Sigurimi i cilësisë - Sigurimi i cilësisë në shkollë lidhet me vendosjen e mekanizmave efektivë për sigurim të cilësisë, funksionimin e departamenteve/aktivave profesionale, koordinimin e aktiviteteve që lidhen me cilësinë, mbështetjen nga komuna, vlerësimin e brendshëm të shkollës dhe planifikimin zhvillimor, monitorimin e mësimeve dhe vlerësimin e performancës së tyre.

Objektivi Strategjik 5: Infrastruktura fizike - Hapësirat e mjaftueshme shkollore dhe funksionale, bëjnë që nxënësit dhe personeli arsimor të ndërveprojnë në mënyrë aktive në zhvillimin e procesit mësimor. Për të arritur këtë, komuna e Podujevës është përcaktuar në arritjen e këtij objekti duke vendosur masa dhe aktivitete, që në fokus kanë përmirësimin e kushteve për zhvillimin e procesit mësimor në të gjitha shkollat e komunës, sigurinë në shkollë, menaxhimin dhe mirëmbajtjen adekuate të hapësirave e objekteve shkollore, etj.

Objektivi Strategjik 6: Arsimi dhe aftësimi profesional - Ndërlidhja arsimit dhe aftësimit profesional me kërkesat e tregut të punës kërkon kohë dhe nuk mund të arrihet pa bashkëpunim me institucionet e relevante dhe bizneset. Fokusi do të jetë në funksionalizimin e firmave ushtrimore, zhvillim të vazhdueshëm profesional i mësimdhënësve dhe instruktorëve, zhvillim të materialeve mësimore, këshillim dhe orientim në karrierë, bashkëpunim me bizneset, pajisjen me mjete të nevojshme të punëtorive të shkollave profesionale për të mundësuar zbatimin e kurrikulave dhe për mësimin praktik me bazë në shkollë.

Orientimi i përgjithshëm

Drejtoria e Arsimit synon që procesi arsimor në Komunën e Podujevës të zhvillohet në një ambient sa më të sigurt, modern dhe miqësor, me personel të kualifikuar dhe të aftësuar në vazhdimësi, me përgjegjësi në punë dhe me një përfshirje cilësore të të gjitha palëve të interesit. DKA synon të ofrojë arsimim gjithëpërfshirës për përvetësimin e njohurive dhe shkathtësive të nevojshme të nxënësve dhe pavarësinë e individit në shoqëri, që të përballët me sukses ndaj ndryshimeve të shpejta, e të gjithmbarshme, në mjedisin ku jetojmë. Drejtoria e Arsimit do të angazhohet për të siguruar arsimim sa më cilësor, i cili do të jetë i pranueshëm për të gjitha grup - moshat e nxënësve, në mënyrë që të kenë mundësi që ta shfrytëzojnë tërë potencialin e tyre.

Mësimdhënësit po ashtu do të kenë mundësi të vazhdueshme për zhvillim (ngritje) profesionale për mësimdhënie duke zbatuar teknikat, metodat dhe strategjitë më bashkëkohore të punës në këtë sferë. Cilësia në arsimim është pikësynimi qëndror, duke synuar që:

- Çdo nxënësi pa asnjë dallim t'i sigurohen kushtet e nevojshme për nxënie cilësore;
- Secilit nxënës t'i ofrohet mundësia e shkollimit dhe arsimimit në mjedisin më të afërt, duke ju përshtatur nevojave të tyre sociale, fizike, kulturore dhe emocionale;
- Shkollat të ofrojnë mjedise të shëndetshme, tërheqëse dhe miqësore, mësimdhënie më cilësore, mjedise më të sigurt dhe më funksionale në misionin që kanë;
- Nxënësit të zhvillojnë shkathtësitë e nevojshme dhe shprehitë e punës për t'iu përgjigjur me sukses sfidave të jetës së përditshme, shkollimit të mëtejshëm në përvetësimin e përhershëm të mësimit me moton "Mësimi gjatë gjithë jetës";

- Shkollat të jenë të hapura, ku prindërit do të kenë mundësi të kyçjes në vendimet të cilat kanë të bëjnë me fëmijët e tyre;
- Mësimdhënësit të aftësohen në mënyrë të vazhdueshme në zbatimin e metodave të ndryshme bashkëkohore në procesin e mësimdhënies për zbatimin e kurrikules.

Rezultatet e pritshme

Për periudhën njëvjeçare Drejtoria e Arsimit synon arritjen e rezultateve, si:

1. Sigurimi i hapësirës dhe kushteve të nevojshme shkollore për organizimin e mësimit online;
2. Sigurimi i përfshirjes së të gjithë nxënësve në procesin edukativo-arsimor sipas skenarëve për mësimin në rast pandemie;
3. Arritja e rezultateve në shkollimin parafillor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, në përputhje me planifikimet e MASHT;
4. Inkurajimi i prindërve dhe i shoqërisë së gjerë në mbështetjen e organizimit të mësimit cilësor;
5. Avancimi i Ekipit Komunal për Vlerësimin pedagogjik të fëmijëve/nxënësve me nevoja të veçanta arsimore dhe vlerësimi i të gjitha rasteve të paraqitura për vlerësim;
6. Realizimi i vlerësimit të brendshëm të performancës së shkollës, në të gjitha shkollat;
7. Organizimi i trajnimit për zbatimin e kurrikulës për të gjithë mësimdhënësit që do të fillojnë ta zbatojnë për herë të parë kurrikulën e re. Organizimi i trajnimit me bazë në shkollë për të gjithë mësimdhënësit e nivelit fillor;
8. Krijimi i rrjetit të bashkëpunimit të koordinatorëve të cilësisë dhe këshilltarëve të karrierës dhe trajnimi i tyre;
9. Miratimi dhe zbatimi i Planit Komunal për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes së shkollës.
10. Zbatimi i Rregulloreve Komunale për Arsim;
11. Informimi i nevojshëm i Kuvendit Komunal për rezultatet, vështirësitë dhe rrjedhën e procesit edukativo - arsimor në tërësi, në komunën tonë.

Monitorimi dhe vlerësimi i përgjithshëm

Qëllimi i përgjithshëm i monitorimit është që të shtohet cilësia në mësimdhënie dhe të nxënë, si dhe të shtohet efikasiteti i punës së institucioneve edukativo-arsimore në komunën e Podujevës.

Gjatë vitit 2026 planifikojmë të realizojmë vizita monitoruese në të gjitha institucionet shkollore, të jemi në kontakt të vazhdueshëm me udhëheqësin e shkollës, mësimdhënësit, nxënësit, shërbimin teknik dhe prindërit me qëllim të ofrimit të ndihmës për ngritje të efikasitetit dhe cilësisë së punës edukativo - arsimore dhe rritjes së të gjitha potencialeve për përparim të vazhdueshëm.

Nëpërmjet monitorimeve të vazhdueshme, anketimeve, pyetësorëve, bashkëbisedimeve dhe shumë instrumenteve tjera, do të realizohet mbikëqyrja për së afërmi e rrjedhës së punës në shkolla. Në këtë drejtim, për ta përmbushur këtë qëllim, ne do të bashkëpunojmë edhe me Sektorin e Inspeksionit të Arsimit (SIA).

Drejtoria duke u bazuar në strukturën e organizimit dhe funksionimit të DKA-ve, në bazë të Udhëzimeve Administrative të MASH-it, punën e vet kryesisht do ta orientojë në:

- Në krijimin dhe mbikëqyrjen e kushteve për punë të institucioneve edukativoarsimore në tri nivelet: 0, 1, 2 dhe 3;
- Mbikëqyrjen e realizimit të plan-programeve mësimore në institucionet edukativoarsimore në të tri nivelet;
- Mbikëqyrjen dhe realizimin e planeve të veprimit të shkollave;
- Përcjelljen dhe mbikëqyrjen e funksionimit të organeve udhëheqëse dhe profesionale të shkollave;
- Vlerësimi dhe mbështetja permanente e fëmijëve/nxënësve me nevoja të veçanta arsimore nga Ekipa Vlerësuese;
- Mbështetjen dhe krijimin e kushteve për punë shtesë të nxënësve me talent të veçantë dhe avancimin e tyre;
- Krijimin e kushteve të punës për stafin profesional të DKA-së, duke bërë aftësimin profesional të tyre përkrah zhvillimit të shoqërisë sonë dhe trendëve më bashkëkohore;

- Zyrtarët Komunal Arsimor vazhdimisht do të mentorojnë dhe monitorojnë punën në shkolla, do të hartojnë edhe raporte për funksionimin e institucioneve arsimore, me qëllim të ngritjes së cilësisë dhe shtimin e përgjegjësisë së të gjithëve në punë;
- Do të ofrohet mbështetje e vazhdueshme për Ekipin për Vlerësimin Pedagogjik të Fëmijëve me Nevoja të Veçanta Arsimore, Ekipet për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit, Koordinatorët e cilësisë, Aktivat profesionale, etj.
- Do të organizohen kurse/trajnime të vazhdueshme në Qendrën për Ngritje Profesionale për zhvillimin profesional të mësimitdhënësve me qëllim të përgatitjes sa më të mirë të mësimitdhënësve për punë efektive në klasë dhe për qasje bashkëkohore në trendët e reja arsimore globale. Do të trajnohen të gjithë mësimitdhënësit e të të gjitha shkollave të cilët në vitin e ri shkollor 2025/26 do të fillojnë me zbatimin e kurrikulës së re.

Të dhënat e përgjithshme

Vitin e ri shkollor 2025/26 e kanë filluar 13946 nxënës

Këta nxënës i vijojnë mësimet në institucionet arsimore të mëposhtme:

- 4 Institucione Parashkollore (publike);
- 36 Shkolla Fillore të Mesme të Ulëta (publike);
- 3 Shkolla të Mesme të Larta (publike);

Pasqyra e numrit të mësimdhënësve dhe nxënësve sipas institucioneve edukativo-arsimore publike

			Numri i Mësimdhënësve			Numri i Nxënësve		
			M	F	Gjithsej	M	F	Gjithsej
1	Gjimnazi "A. Xhuvani"	Podujevë	45	41	86	449	897	1346
2	SHMT "Fan S. Noli"	Podujevë	48	34	82	651	94	745
3	SHME "Isa Boletini"	Podujevë	49	44	93	388	588	976
1	Çerdhja "Armela "	Podujevë	1	21	22	108	66	174
2	Çerdhja "Armela " 1	Podujevë	0	9	9	27	33	60
3	Çerdhja "Armela "2	Lluzhan	0	6	6	24	31	55
4	Çerdhja "Armela "3	Sfeçël	0	4	4	27	20	47
5	Çerdhja "Armela "4	Kerpimeh	0	4	4	8	12	20
1	"Shaban Shala"	Podujevë	3	43	46	445	531	976
2	"Naim Frashëri"	Podujevë	20	34	54	504	515	1019
3	"Enver Maloku"	Podujevë	17	20	37	298	330	628
4	"Xheladin Rekalii"	Podujevë	8	23	31	208	240	448
5	"Dëshmorët e Kombit"	Podujevë	9	18	27	127	142	269
6	" Zenel Hajdini "	Lupç i Posh.	6	11	17	111	107	218
7	"Drita"	Majac	9	14	23	70	86	156
8	"Afrimi e Fahriu"	Lluzhan	9	15	24	158	202	360
9	"Rilindja"	Hërticë	4	9	13	11	16	27
10	" Musli Dumoshi "	Dumosh	2	8	10	59	56	115
11	"Zahir Pajaziti"	Orllan	12	11	23	50	46	96
12	"Naum Veqilharxhi"	Llap. e Epërme	6	7	13	83	111	194
13	"Nuhi Gashi"	Bradash	10	14	24	105	141	246
14	"Luigj Gurakuqi"	Batllavë	16	20	36	208	245	453
15	"Lasgush Poradeci"	Dumnicë	4	12	16	70	65	135
16	"Ali Hadri"	Obrançë	16	20	36	177	209	386
17	"Ali Ajeti"	Sfeçël	16	30	46	250	233	483
18	"Shefki Kuleta"	Tërnavë	13	22	35	136	151	287
19	"Esad Mekuli"	Dobratin	9	4	13	85	95	180
20	"Kadri Kadriu"	Llaushë	9	18	27	86	77	163
21	"Jahë Hasani"	Bërvenik	4	4	8	7	4	11
22	"Sheqë Mirofci"	Shtedim	6	10	16	95	92	187
23	"Shefki Latifi"	Pollatë	9	6	15	31	33	64
24	"Dituria"	Llap. e Posh.	5	11	16	78	86	164
25	"Hamit Sejdiu"	Kërpimeh	13	18	31	137	146	283
26	"Emin Duraku"	Bajçinë	8	11	19	113	96	209
27	"Kongresi i Manastirit"	Gllamnik	9	31	40	256	250	506
28	"Hasan Ramadani"	Shajkofc	7	11	18	84	66	150
29	"Jetullah Gashi"	Dobërdol	4	6	10	56	62	118
30	"Eqrem Çabej"	Buricë	3	10	13	48	79	127
31	"Ilir Konushevc	Llugë	10	11	21	142	145	287
32	"Hyzriu e Samiu"	Letanc	7	9	16	122	152	274
33	"Jetullah Islami"	Dyz	5	6	11	17	14	31
34	" Elfir Behrami "	Metehi	4	7	11	46	32	78
35	"Pavarësia"	Sibofc	4	8	12	119	100	219
36	"Dr. Ibrahim Rugova"	Podujevë	10	30	40	472	504	976
			449	705	1154	6746	7200	13946

Stafi Administrativ dhe punëtorët Teknik

Nr	Emri i shkollës	Vendi	Drejtorat zv drejtorat			Sekretart			Stafi teknik		
			M	F	Gjithsej	M	F	Gjithsej	M	F	Gjithsej
1	Gjimnazi "A. Xhuvani"	Podujevë	2		2		1	1	5	6	11
2	SHMT "Fan S. Noli"	Podujevë	1	1	2	1		1	4	6	10
3	SHME "Isa Boletini"	Podujevë	2		2	1		1	7	2	9
0	Çerdhja "Armela "	Podujevë		1	1		2	2	2	10	12
1	"Shaban Shala"	Podujevë	1	1	2		1	1	9		9
2	"Naim Frashëri"	Podujevë	1	1	2		1	1	6		6
3	"Enver Maloku"	Podujevë	1		1		1	1	8		8
4	"Xheladin Rekalju"	Podujevë	1		1	1		1	4	1	5
5	"Dëshmorët e Kombit"	Podujevë	1		1		1	1	2	2	4
6	" Zenel Hajdini "	Lupç i Posh.		1	1	1		1	4		4
7	"Drita"	Majac	1		1				4		4
8	"Afrimi e Fahriu"	Lluzhan		1	1				2	1	3
9	"Rilindja"	Hërticë	1		1				3		3
10	" Musli Dumoshi "	Dumosh		1	1				2		2
11	"Zahir Pajaziti"	Orllan	1		1				5		5
12	"Naum Veqilharxhi"	Llap. e Epërme	1		1				2		2
13	"Nuhi Gashi"	Bradash	1		1				4		4
14	"Luigj Gurakuqi"	Batllavë	1		1	1		1	7		7
15	"Lasgush Poradeci"	Dumnicë	1		1		1	1	3		3
16	"Ali Hadri"	Obrançë		1	1		1	1	6		6
17	"Ali Ajeti"	Sfeçël	1		1	1		1	6		6
18	"Shefki Kuleta"	Tërrnavë	1		1				5		5
19	"Esad Mekuli"	Dobratin	1		1				2		2
20	"Kadri Kadriu"	Llaushë	1		1				4		4
21	"Jahë Hasani"	Bërvenik							2		2
22	"Sheqë Mirofci"	Shtedim	1		1				2		2
23	"Shefki Latifi"	Pollatë	1		1				5		5
24	"Dituria"	Llap. e Posh.	1		1				3		3
25	"Hamit Sejdiu"	Kërpimeh		1	1				5		5
26	"Emin Duraku"	Bajçinë	1		1		1	1	3		3
27	"Kongresi i Manastirit"	Gllamnik	1		1	1		1	5		5
28	"Hasan Ramadani"	Shajkofc	1		1				2		2
29	"Jetullah Gashi"	Dobërdol	1		1				2		2
30	"Eqrem Çabej"	Buricë		1	1				2		2
31	"Ilir Konushevcu"	Llugë	1		1		1	1	2		2
32	"Hyzriu e Samiu"	Letanc		1	1		1	1	3	1	4
33	"Jetullah Islami"	Dyz	1		1				2		2
34	" Elfir Behrami "	Metehi	1		1				3		3
35	"Pavarësia"	Sibofc		1	1				2		2
36	"Dr. Ibrahim Rugova"	Podujevë	1	1	2	1		1	6	3	9
Gjithsej			32	13	45	8	12	20	155	32	187

Pedagoget, Psikologët Asistent për FNV dhe Bibliotekistet nëpër shkolla

Nr	Emri i shkollës	Vendi	Pedagog			Psikolog			Asistent për fëmij me nevoja të veçanta			Bibliotekist		
			M	F	Gjith.	M	F	Gjith.	M	F	Gjith.	M	F	Gjith.
1	Gjimnazi "A. Xhuvani"	Podujevë		1	1		1	1					1	1
2	SHMT "Fan S. Noli"	Podujevë					1	1					1	1
3	SHME "Isa Boletini"	Podujevë					1	1					1	1
0	Çerdhja "Armela "	Podujevë								2	2			
1	"Shaban Shala"	Podujevë		1	1	1		1		3	3		1	1
2	"Naim Frashëri"	Podujevë				1		1		3	3		1	1
3	"Enver Maloku"	Podujevë		1	1		1	1		1	1	1		1
4	"Xheladin Rekalju"	Podujevë		1	1					1	1		1	1
5	"Dëshmorët e Kombit"	Podujevë							1		1		1	1
6	"Zenel Hajdini "	Lupç i Posh.												
7	"Drita"	Majac											1	1
8	"Afrimi e Fahriu"	Lluzhan								1	1			
9	"Rilindja"	Hërticë												
10	"Musli Dumoshi "	Dumosh												
11	"Zahir Pajaziti"	Orllan											1	1
12	"Naum Veqilharxhi"	Llap. e Epërme										1		1
13	"Nuhi Gashi"	Bradash												
14	"Luigj Gurakuqi"	Batllavë								1	1	1		1
15	"Lasgush Poradeci"	Dumnicë												
16	"Ali Hadri"	Obrancë											1	1
17	"Ali Ajeti"	Sfeçël					1	1						
18	"Shefki Kuleta"	Tërrnavë										1		1
19	"Esad Mekuli"	Dobratin												
20	"Kadri Kadriu"	Llaushë												
21	"Jahë Hasani"	Bërvenik												
22	"Sheqë Mirofci"	Shtedim												
23	"Shefki Latifi"	Pollatë												
24	"Dituria"	Llap. e Posh.											1	1
25	"Hamit Sejdiu"	Kërpimeh												
26	"Emin Duraku"	Bajçinë												
27	"Kongresi i Manastirit"	Gllamnik					1	1					1	1
28	"Hasan Ramadani"	Shajkofc												
29	"Jetullah Gashi"	Dobërdol												
30	"Eqrem Çabej"	Buricë										1		1
31	"Ilir Konushevc	Llugë											1	1
32	"Hyzriu e Samiu"	Letanc								1	1			
33	"Jetullah Islami"	Dyz										1		1
34	"Elfir Behrami "	Metahi										1		1
35	"Pavarësia"	Sibofc												
36	"Dr. Ibrahim Rugova"	Podujevë		1	1		1	1	1	2	2		1	1
Gjithsej				5	5	2	7	9	2	15	17	7	14	21

Numri i nxënësve me nevoja të veçanta në vitin shkollor 2023/24

Numri i nxënësve me nevoja të veçanta, që do ta ndjekin mësimin në këtë vit shkollor, në nivel komune është 196 nxënës, për të gjitha nivelet shkollore. Kuptohet, ky numër është i deklaruar nga shkollat në Bazën e të dhënave zyrtare - SMIA (Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim).

Lloji i dëmtimeve	Numri i nxënësve
Dëmtime intelektuale	12
Dëmtime në të dëgjuar	8
Dëmtime në të parë	75
Dëmtime fizike	8
Dëmtime të shumëfishta	18
Vështirësi në të folur, komunikim dhe të gjuhës	48
Autizëm	18
Çrregullime emocionale dhe të sjelljes	15
Vështirësi/Çrregullime në të nxënë	25
Sindromi Daun	16
Gjithsej	243

Personeli arsimor nga komuniteti jo shumicë

	Nr i pjesmarsve
Meshkuj	3
Femra	2
Totali	5

Personeli arsimor me nevoja të veçanta

	Nr i pjesmarsve
Meshkuj	3
Femra	3
Totali	6

Aktivitetet e DKA-së në Podujevë për vitin 2026

Aktivitetet	Koha e realizimit												Implementues
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
Përgatitja teknike e objekteve shkollore: gëlqerosja, riparimi infrastrukturorë, riparimi i inventarit ekzistues dhe pajisja me inventar të ri.							V	V				V	DKA
Realizimi i procedurave për përzgjedhjen e operatorit furnizues me lëndë djegëse							V						DKA
Përzgjedhja e operatorit për furnizimin e shkollave me lëndën djegëse në koordinim me Zyrën e Prokurimit								V					DKA
Furnizimi i shkollave me lëndë djegëse								V					DKA
Kontrollimi i sistemit të ngrohjeve nëpër shkolla							V	V					DKA
Përcjellja e punëve në ndërhyrjet infrastrukturorë në shkolla							V	V	V	V	V	V	DKA MASH
Riparimi i nyjeve të ujësjellësve dhe përmirësimi i furnizimit të shkollave të cilat kanë problem me ujë të pijshëm							V	V				V	DKA
Furnizimi i shkollave me mjete mësimore didaktike e kabinetike për lëndët: TIK, Matematikë, Fizikë, Kimi, Biologji, etj.							V	V					DKA Donatorët
Furnizimi i shkollave me inventarë shkollore: banka, karrige, tavolina, tabela dhe dollapë për bibliotekat shkollore							V	V					DKA
Rregullimi i shkollave dhe oborreve shkollore				V	V	V	V	V					DKA
Rregullimi i terreneve sportive				V	V	V	V	V					DKA
Furnizimi dhe mbikëqyrja e furnizimit të nxënësve me tekste							V	V					MASH DKA
Furnizimi i shkollave me mjete higjienike dhe aparate për shuarjen e zjarrit	I përherëshëm, sipas nevojës												DKA
Furnizimi i shkollave me material për administratën e shkollave	Sipas kërkesave												DKA
Furnizimi i shkollave me karburant për gjeneratorët	Sipas kërkesave												DKA
Furnizimi i shkollave me materiale për zhvillimin e aktiviteteve të lira sipas prioritetëve të shkollave	Sipas kërkesave												DKA

Aktivitetet që kanë të bëjnë me procesin edukativo – arsimor

Aktivitetet	Koha e realizimit												Implementues
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
Organizimi i mësimit shtesë për maturantët				V	V								Shkollat
Sigurimi i një ambienti të shëndetshëm për shkollën dhe rregullimi i këndeve të gjelbëruara shkollore				V	V	V	V	V	V				DKA
Organizimi i trajnimeve për mësimdhënës në Qendrën për Ngritje Profesionale sipas Prioriteteve të Planit për Zhvillimin Profesional të Mësimdhënësve.	V	V	V	V	V	V	V	V	V	V	V	V	DKA MASH Donatorët
Përcjellja e braktisjes së nxënësve-detyrë permanente	V	V	V	V	V	V	V	V	V	V	V	V	DKA
Bashkëpunimi me OJQ në fushën e realizimit të drejtave të fëmijëve dhe sigurisë së nxënësve në shkolla, kundër trafikimit, punës së fëmijëve në rrugë, etj.		V	V	V	V	V	V		V	V	V	V	DKA
Analiza e punës edukativoarsimore	V	V	V	V	V	V	V	V	V	V	V	V	DKA MASH
Përcjellja e lëvizjes së personelit arsimor	I përhershëm, sipas nevojës												DKA
Shpallja e konkurseve për plotësimin e vendeve të lira të punës sipas kërkesave të shkollave	Sipas nevojës duke i respektuar afatet dhe procedurat												DKA
Plotësimi i vendeve të lira të punës	Sipas nevojës duke i respektuar afatet dhe procedurat												DKA
Vlerësimi i punës edukativo arsimore të shkollave nëpërmjet të vizitave dhe bashkëpunimit me prindër				V	V	V			V	V	V	V	DKA
Përgatitja profesionale e arsimtarëve, organizimi i trajnimeve					V	V				V	V	V	DKA
Përgatitjet për kremtimin e festave shtetërore	V	V						V	V	V	V	V	MASH DKA
Organizimi i vizitave studimore me stafin e DKA-së jashtë vendit	Sipas kërkesave, ftesave												DKA
Përcjellja permanente e aktiviteteve mësimore e jashtë mësimore të nxënësve nëpër shkolla	E vazhdueshme												DKA

Organizimi dhe mbajtja e garave me titull : "Gjuhëtari i ri " në shkallë komunale dhe në shkallë vendi					V	V							DKA DKRS Shkollat
Organizimi dhe mbajtja e garave të shkollave të recituesve si dhe festivali i dramës					V								DKA DKRS Donatorët
Përcjellja e realizimit të mbrëmjeve të maturës					V	V							DKA Shkollat
Mbarimi i mësimit për maturantët	14 maj 2026												Shkollat
Mbarimi i mësimit për semimaturantë dhe shkolla të mesme të larta	5 qershor 2026												Shkollat
Mbarimi i mësimit për parafillorët dhe klasat 1-8	19 qershor 2026												Shkollat
Riprovimet për nxënësit që nuk kanë treguar rezultate pozitive në disa lëndë mësimore	qershor - korrik 2026												Shkollat
Publikimi i rezultateve të provimit shtetëror të maturës	Korrik 2026												MASH DKA
Shqyrtimi i ankesave eventuale të parashtruara nga nxënësit	Korrik 2026												MASH DKA
Publikimi i rezultateve të shqyrtimit të ankesave	Korrik 2026												MASH DKA

Bashkëpunimi i DKA-së me organet e sigurisë, OJQ-të, mediat dhe komunitetin

Aktivitetet	Koha e realizimit												Implementues
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
Pjesëmarrja në debatet me temë arsimore e shoqërore organizuar nga OJQ-të	Sipas organizimit dhe ftesës												DKA
Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës	Sipas nevojës												DKA
Kontaktet me përfaqësues të KFOR-it dhe të organizatave ndërkombëtare	Sipas nevojës												DKA
Bashkëpunimi me organizata të ndryshme vendore e të huaja	Sipas nevojës												DKA
Bashkëpunimi me donatorë vendorë e të huaj	Sipas nevojës												DKA

**Aktiviteti dhe bashkëpunimi i DKA-së me Kryetarin e Komunës, MASH-in, Drejtoritë
Komunale dhe me Qytetarët**

Aktivitetet	Koha e realizimit												Implementues
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
Takimet dhe konsultimet me kryetarin e Komunës	<i>Të përhershme, sipas nevojës</i>												DKA
Takimet e rregullta me ministrin e arsimit, në kuadër të takimeve me drejtorët e DKA-ve	<i>Të përhershme, varësisht nga ftesat</i>												DKA MASH
Furnizimi me ligjet e reja, udhëzimet, vendimet dhe rregulloret që dalin nga MASH	<i>Sipas nevojës</i>												DKA MASH
Përcjellja e kërkesave, shkresave, raporteve dhe informatave nga aktiviteti i DKA-së në MASH	<i>Sipas nevojës</i>												DKA MASH
Kontaktet e rregullta me Departamentin e Arsimit Parauniversitar, Infrastrukturës, Njësinë për Vlerësime dhe zyrtarë të ndryshëm arsimor	<i>Sipas nevojës</i>												DKA MASH
Pjesëmarrja e rregullt në mbledhjet e Kolegjiumit të Drejtorëve të DKA-ve të Kosovës	<i>Të përhershme, varësisht nga ftesat</i>												DKA
Takimet e rregullta me drejtorët e shkollave fillore, të mesme dhe institucionit parashkollor	V		V		V	V	V		V	V	V	V	DKA
Pranimi i raporteve mujore të punës nga drejtorët e shkollave dhe shqyrtimi i tyre.		V	V	V	V	V	V		V	V	V	V	DKA
Bashkëpunimi i rregullt me drejtorët e drejtorive komunale, në veçanti me DKRS	<i>I përhershëm, sipas nevojës</i>												DKA
Bashkëpunimi i rregullt me Sektorin e Inspektionit të Arsimit	<i>Sipas nevojës</i>												DKA
Puna me palë, shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave	<i>E përditshme dhe sipas kërkesave</i>												DKA

Bashkëpunimi me përfaqësuesin e komunës për implementimin e projekteve që kanë të bëjnë me Integrimet Evropiane

Aktivitetet	Koha e realizimit												Implementues
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
Përmirësimi i infrastrukturës, sigurimi i transportit dhe rritja e sigurisë në shkolla	Në vazhdimësi												DKA DSHPMSH
Hartimi i programeve, planprogrameve dhe përgatitja e moduleve të trajnimit të mësimdhënësve	Në vazhdimësi												DKA
Përmirësimi i infrastrukturës ligjore për të favorizuar pjesëmarrje dhe punësim më të barabartë në pozitë udhëheqëse në institucionet arsimore	Në vazhdimësi												DKA
Identifikimi i shkollave që kanë nevojë për ndërtim dhe renovim, si dhe hartimi i listës prioritare	Në vazhdimësi												DKA DSHPMSH
Përgatitjet dhe kompletimi i dokumentacioneve për projekte (paramasat dhe parallogaritë) e ndërtimeve të objekteve shkollore	Në vazhdimësi												DKA DSHPMSH
Zgjerimi i hapësirave-lokaleve ekzistuese shkollore (renovimi) dhe mbikëqyrja e punëve gjatë renovimeve	Në vazhdimësi												DKA DSHPMSH
Identifikimi i nevojave për materiale dhe pajisje, si dhe përcaktimi i prioriteteve të shkollave me nevoja më të theksuara	Në vazhdimësi												DKA DSHPMSH
Implementimi i Strategjisë për Arsimimin e Komuniteteve	Në vazhdimësi												DKA DSHPMSH
Përfshirja e fëmijëve të komuniteteve në arsimin parashkollor	Në vazhdimësi												DKA DSHPMSH

- * Buxhetin i arsimit për vitin 2026 sipas kategorive,
- * Programin e investimeve kapitale, mallrave dhe shërbimeve për vitin 2026,
- * Planifikimin e të hyrave vetanake komunale për vitin 2026,
- I gjeni të bashkangjitur në kornizen afatmesme buxhetore dhe në planin e prokurimit në webfaqen e komunës së Podujevës

Podujevë 2026

Drejtor i Arsimit

Msc. Avni Fetahu

